



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 232, Datë 12.09.2022

MBI

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E LICENCIMIT TË SHOQËRISË “BREÇANI R.O.S.P” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “DRITA” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 KW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 113, pika 3 të ligjit nr. 144/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.09.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1528/1 prot., datë 08.09.2022 “Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Drita” me kapacitet të instaluar 1980 kW”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 09, datë 21.01.2022, ka licencuar shoqërinë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Drita”, për një afat 30 vjeçar. Ndër të tjera ky vendim përcakton kushtet si vijon:
 - 2. Shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., duhet të paraqesë në ERE çdo vit kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.07.2018, të rinovuar, **brenda datës 18 Gusht të çdo viti**, deri në përfundim të afatit 10 vjeçar që ajo përcakton.
 - 4. Shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., të depozitojë në ERE Certifikatën e Pronësisë për tokën shtet, me Kartelën Shoqëruese me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë për ushtrimin e veprimtarisë së HEC “Drita”, jo më vonë se një muaj nga paisja me këtë dokument.
- Në kuadër të plotësimit të këtyre kushteve, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 37/3 prot., datë 28.07.2022, duke i kërkuar informacion.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 37/4, datë 04.08.2022, ka përcjellë shkresën me të cilën i është drejtuar Bashkisë Tropojë në lidhje me mos rinovimin e kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor Kullosor, për arsye se shoqëria ka përmbushur gjithë detyrimet kontraktore.

- Po ashtu shoqëria ka bërë me dije se gjurma e projektit të Hidrocentralit shtrihet në dy zona kadastrale me nr. 1133, fshati Begaj dhe nr. 3404, fshati Shoshan, Bashkia Tropojë në pasuritë me status juridik shtet.
- Për gjithë sa më sipër, duke qenë se nuk njihemi ende me ndonjë komunikim të Bashkisë Tropojë në lidhje me përfundimin e kontratës së qirasë për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor, nr. 2693/5 prot., datë 18.07.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, me objekt lejimin e hapjeve të kanaleve, shtrirjen e tubacionit dhe të drejtën e kalimit dhe përdorimit në funksion të ndërtimit të HEC "Drita", me qëllim për të sqaruar çështjen e rregullimit pronësor në tërësi, vlerësojmë që afati i parashikuar në pikën 2 të vendimit të licencimit nr. 09, datë 21.01.2022 të ndryshohet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit nr. 9, datë 21.01.2022, ndryshon si vijon:

2. Shoqëria “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k., duhet të paraqesë në ERE kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.07.2018, të rinovuar, apo çdo dokument tjetër që i shërben realizimit të saj brenda 30 ditëve pune nga marrja dijani.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “BREÇANI R.O.S.P” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI